

PROCESVERBAL
nga seanca e 4-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 25.01.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional: Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Ognen Nedelkovski, Jeton Ismaili, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë : Ljupço Zlatev nga SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, Ilija Xhingoski, autorizues i SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup dhe Vasko Magleshov nga Prizma.

Z. Petrushevski hapi seancën e 4-ët të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:10 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 15.01.2024.
2. Propozim - Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Metropolis Radio SHPK Shkup, për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.
5. Propozim – vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Marrje me qira e hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore.

7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja e instalimit SPRINKLER zjarrfikës (nënstacion i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtje e pajisjeve AKZ.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 15.01.2024.

Z. Fidanoski kishte shënim në lidhje me diskutimin e tij, ai propozoi në faqen 4 të procesverbalit, për shkak të përsëritjes së fjalëve të njëjta, të fshihet formulimi i parë që thotë "në funksionimin e tij" dhe të lihet vetëm i dyti.

Këshilli i Agjencisë, me korrigjimin e propozuar nga z. Fidanoski, njëzëri e miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 3- të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 15.01.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Petrushevski në lidhje me Propozimin - vendimin për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, shpjegoi se në pajtim me diskutimin e mbajtur në seancën e mëparshme të 3-të publike, këtë pikë do ta shtyjë për të hënë. 29.01 2024.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar. Ai shpjegoi se ky transmetues, sikur edhe ai i mëparshmi, nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio. Është e nevojshme të ketë dy të punësuar dhe megjithë komunikimin më të gjatë me radion, ai nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm. Për këtë arsye, propozohet që të inicohet procedura për heqjen e lejes.

Z. Petrushevski tha se edhe ky transmetues do të ketë afat deri në 15 ditë për të mënjanuar mospërputhjet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-437 datë 15.08.2016, për shkak se nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm nga i cili mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren e lartpërmendur, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, PA1 nr.08-

437 datë 15.08.2016, për shkak të shkeljes së nenit 62 paragrafi (6) të LSHMAAV dhe nenin 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 dhe nenin 83 paragrafi 3 të LSHMAAV.

Z. Petrushevski i propozoi shërbimit që pas përfundimit të seancës, transmetuesi menjëherë të njoftohet për afatin e fundit, në mënyrë që të mos vihet në situatë që t'i hiqet leja.

Pika 4

Udhëheqësi i njësisë për identitet kulturor Ognen Nedelkovski, ka shpjeguar propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Metropolis Radio SHPK Shkup për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ai shpjegoi se pas parashtrës nga dëgjues të dërguar më 12.01.2024, Sektori për çështje programore ka kryer mbikëqyrje mbi radion gjatë së cilës ata kanë dëgjuar për 5 ditë, 9, 10, 11, 12 dhe 13 janar 2024 . Me mbikëqyrje u konstatua se në 5 ditët e programit është transmetuar emisioni "Radio aukcija", i cili ka zgjatur rreth 1 orë, ku njoftimet e prezantuesit janë transmetuar burimisht në gjuhën kroate, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase. Prandaj, Këshillit i propozohet që të shqiptohet masë paralajmëruese me shkrim.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme programore, sipas parashtrës (UPP 0309/1 datë 12.01.2024), nr. 1001-251/1 të datës 15.01.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR Metropolis Radio SHPK Shkup t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 9, 10, 11, 12 dhe 13 janar 2024 , në emisionin "Radio aukcija", njoftimet e prezantuesit janë transmetuar burimisht në gjuhën kroate, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit. të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike dhe furnizik publik të hartojë Vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendim për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva e shpjegoi Propozimin - vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë së SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip. Ai shpjegoi se është kërkuar pajtim për

përfaqësimin e plotë të pronarit ekzistues të këtij televizioni dhe përfaqësim të personit juridik Xhomnet 328 SHPK Beograd, themelues i vetëm i të cilit është personi fizik nga Maqedonia. Janë bërë kontrole në Regjistrin Qendror të RMV-së, ku është konstatuar se as personi juridik dhe as personi fizik nuk figurojnë si themelues të shoqërive të tjera tregtare në vendin tonë. Njoftimi është i plotë dhe i rregullt dhe për këtë arsye propozohet miratimi i ndryshimit të kërkuar

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJP Shtip, me tekstin siç është propozuar në Vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJP Shtip, nuk krijohet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Marrje me qira të hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore. Ai shpjegoi se Agjencia gjatë kryerjes së detyrimeve ligjore, miraton vendime dhe akte që përveç në Gazetën Zyrtare të RMV-së, të njëjtit duhet të shpallen edhe në gazetatat ditore që shpallen në mbarë territorin e vendit. Për këto arsye duhet të zbatohet kjo procedurë, e cila do të jetë furnizim i ndashëm dhe sipas vlerës së parashikuar do të jetë furnizim me vlerë të ulët. Njoftimi për furnizimi do të shpallet në sistemin elektronik për furnizim publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik: Marrja me qira e hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Marrje me qira e hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore është paraparë dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1, datë 22.12.2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja e instalimit SPRINKLER zjarrfikës (nënstacioni i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtja e pajisje AKZ. Ai shpjegoi se furnizimi është planifikuar për periudhë dy vjeçare, do të zbatohet si furnizim grupor, pra me Agjencinë për Rini dhe Sport, pasi që të dyja institucionet janë të vendosura në të njëjtin objekt. Furnizimi do të zbatohet si procedurë e thjeshtuar që është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë, ndërsa mjetet janë të siguruara nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024, pra do të jenë parashikuar më tej në Planin Financiar për vitin 2025. Njoftimi do të publikohet në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtjen e instalimit SPRINKLER zjarrfikës (nënstacion të thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtjen e pajisjeve AKZ, për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Mirëmbajtja e instalimit SPRINKLER zjarrfikës (nënstacion të thatë, spërkatës dhe pompa) dhe mirëmbajtja e pajisjeve AKZ është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024, pra do të sigurohen më tej në Planin financiar për vitin 2025.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**